



VENDIM

Nr.44 Datë 28.05.2009

PËR

**MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË PRONËSISË SË AKSIONEVE TË
OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A (OSSH)**

Në mbështetje të neneve 9, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, Ligjit Nr. 10116, Datë 23.04.2009, “Për Miratimin e Kontratës së Shitjes së 76% të Aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a) ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ a.s-së”, paragrafit 5.2 të “Licensës së Aktivitetit të Furnizimit Publik me pakicë të Energjisë Elektrike” miratuar me vendimin Nr.71, datë 24.06.2008, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, dhe vendimit Nr.69, datë 24.06.2008 “Për Miratimin Licensës së Aktivitetit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 28.05.2009, mbasi shqyrtoi kërkesën e OSSH- sh.a për miratimin e transferimit të pronësisë së aksioneve që përfaqësojnë 76% të kapitalit aksioner të shoqërisë OSSH sh.a, nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës (që vepron në cilësinë e përfaqësuesit të Republikës së Shqipërisë), tek shoqëria CEZ a.s,

Vendosi

1. Të miratoje transferimin e pronësisë së aksioneve që përfaqësojnë 76% të kapitalit aksioner të shoqërisë OSSH sh.a, nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës (që vepron në cilësinë e përfaqësuesit të Republikës së Shqipërisë), tek shoqëria CEZ a.s, nga momenti i kryerjes së cdo transferimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtje së Konsumatorit për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari I ERE-s
Bujar Nepravishta
Ne mungese dhe me porosi
Ardian Haci**